



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.758/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.11.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k nga procedura e prokurimit “*Kërkesë Për Propozime*”, me Nr. REF-29303-10-10-2017, me objekt Loti I “*Baze e Fortë*” me fond limit 5,976,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr.2 sha Tiranë.

Ankimues: “Murati D” shpk
Rruga e Kavajës, ish Kombinati Ushqimor, Godina 1 katëshe Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr.2 sha Tiranë.
Rruga “Artan Lenja”, Fusha e Aviacionit

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë, 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak


I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes



II.1. Në datën 10.10.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë Për Propozime”, me Nr. REF-29303-10-10-2017, me objekt Loti I “Baze e Fortë” me fond limit 5,976,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Trajtimit të Studentëve Nr.2 sha Tiranë.

II.2. Në datën 23.10.2017 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 30.10.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Himi	3,909,000	I skualifikuar
Murati D	4,278,000	I skualifikuar
M.Lezha	4,779,000	I skualifikuar
Bolt	5,310,000	I skualifikuar
Shaga	5,502,000	I skualifikuar
Muca	5,544,000	I skualifikuar
Paera	5,820,000	I skualifikuar

II.4. Në datën 13.11.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

Himi	3,909,000	I skualifikuar
Murati D	4,278,000	I skualifikuar
M.Lezha	4,779,000	I kualifikuar
Bolt	5,310,000	I skualifikuar
Shaga	5,502,000	I kualifikuar
Muca	5,544,000	I skualifikuar
Paera	5,820,000	I skualifikuar

II.5. Në datën 30.10.2017 operatori ekonomik “Murati D” shpk është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentat si më poshtë:

- *Operatori Ekonomik nuk ploteson kriterin e vendosur ne piken 2.3 germa c, kapaciteti teknik, pjese e kriterëve te vecanta per kualifikim ku kerkohen paraqitja e mostrave sipas specifikimeve teknike.*
- *Dollapi 1-kanat nuk eshte i paisur me mentesha qe sigurojne mbylljen e bute.*
- *Tavolina e drurit nuk eshte ne lartesine e kerkuar ne specifikimet teknike me permasa 70 cm x90 cm x 70 cm, por eshte me permasa 90cm x 90cm x 72 cm.*
- *Trashesia e PVC te supripes se tavolines se drurit, nuk eshte 2mm por eshte 1.8mm.*

III.6. Në datën 02.11.2017 operatori ekonomik “Murati D” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit se, Dollapi 1-kanat nuk eshte i paisur me mentesha qe sigurojne mbylljen e bute, me fjalë të tjera dy gomina që sigurojnë mbylljen pa zhurmë. Kjo është e vërtetë por këto dy mantesha që i quani ju nuk e risin aspak koston, është një fenomen harrese dhe në specifikime tëknike është thënë se shoqëria garanton cilësinë sipas specifikimeve teknike që parashtrojnë DST. Në këtë kuptim KVO nuk do e kishte vlerësuar si të pavlefshëm mostrën pasi në vlerë ku 300 copë x25 lekë/copa bëjnë 7500 lekë dëm për ofertën ose rritje të saj në vlerë. Për shoqërinë tonë marrja në konsideratë e këtij elementi është teke e thjeshtë e KVO-së ku nuk përbën fakte për moskualifikim.*
- *Lidhur me arsyen e dytë dhe të të tretë të skualifikimit se Tavolina e drurit nuk eshte ne lartesine e kerkuar ne specifikimet teknike me permasa 70 cm x90 cm x 70 cm, por eshte me permasa 90cm x 90cm x 72 cm. si dhe Trashesia e PVC te supripes se tavolines se drurit, nuk eshte 2mm por eshte 1.8mm , duke shkelur gjatësinë më 10 cm më e madhe ku kjo mund të shkurtohej gjatë realizimit të tenderit dhe larësia sipas tyre është 2 cm më e lartë dhe kjo mund të shkurtohej, kurse supripina me ndryshim 2 mm është e papërfillshme dhe vetë standartet i përmbajnë + dhe – 5 cm e jo më 2 mm por që të gjitha janë të rregullueshme gjatë realizimit të tenderit. Të gjitha këto për vlerën e ofertës për*

tavolinën meqënëse të gjitha përmasat me përjashtim të suprinës 2 mm janë më të mëdha tregon se ne kufijtë real gjatë realizimit do të ulnin vlerën totale me 100 lekë copa x 50 lekë copa bëjnë 12000 lekë më shumë që duhet ti zbritet shumës totale dhe oferta do të kishte vlerë më të ulët se realja.

- *Këto janë difekte të vogla të cilat nuk ndryshojnë as konstruktin as formën apo thelbin e mobiljeve, janë elementë të papërfillshëm në kualifikim. Këtu nuk kemi asnjë humbje ekeonomike. Gabimi në mobililje pranohet plus minus deri në 5 cm e jo më me mm. Kërkojmë kualifikimi e ofertës sonë.*

II.7. Në datën 06.11.2017, me shkresën nr. 407/4 prot operatori ekonomik ankimues “Murati D” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.8. Në datën 14.11.2017, operatori ekonomik ankimues “Murati D” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr.442 prot., datë 20.11.2017 protokolluar me tonën me nr.1697/2 datë 20.11.2017 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Murati D” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt ankimi, me argumentat se “*Dollapi 1-kanat nuk eshte i paisur me mentesha qe sigurojne mbylljen e bute. ;Tavolina e drurit nuk eshte ne lartesine e kerkuar ne specifikimet teknike me permasa 70 cm x90 cm x 70 cm, por eshte me permasa 90cm x 90cm x 72 cm; Trashesia e PVC te suprines se tavolines se drurit, nuk eshte 2mm por eshte 1.8mm*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/c “Kapacitetit Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

c. Operatoret ekonomik duhet të paraqesin një mostër sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor për secilin nga artikujt e kërkuar në preventiv. Mostrat do të paraqiten pranë Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr.2” Tiranë.

Mosparaqitja e mostrave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor për të gjithë mallrat objekt prokurimi është kusht për skualifikim.

- *Artikujt e mesiperm duhet te shoqerohen me etikete ne te cilen te identifikohet emeri i Operatorit Ekonomik.*
- *Mostrat do tu kthehen mbrapsht operateve ekonomik me kerkese te tyre pas lidhjes se kontrates me operatorin fitues.*

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikime Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER MATERIALE HOTELERIE “BAZE E FORTE”

<i>EMËRTIMI I MATERIALIT</i>	<i>SPECIFIKIME TEKNIKE</i>
<i>Dollap druri 1 -kanat</i>	<p><i>Dollap rrobash 60cm x 45cm x 220cm-h</i> <i>Struktura duhet të jetë e ndërtuar me panele prej materiali lëndë drusore e veshur me shtrese melaminike me nuance të çelur. Ne të gjithë perimetërin të jete i rrethuar me material PVC me të njëjten ngjyre e trashësi 2 mm. Kembet e dollapit të jene të pajisura me aksesore plastik për mbrojtjen e gërvishjes së dyshemese . Dollapi duhet të ketë 3 ndarje horizontale, peshembajtja e shperndare e seciles ndarje jo me pak se 100 kg. Dollapi të jete i organizuar me një ndarje vertikale e paisur me aksesor për varjen e rrobave. Montimi dhe cmontimi të behet me paisje të posacme dhe cilesore. Kanata të paisen me mentesha që sigurojnë mbyllje të bute . Materiali i perdorur për kete objekt të jete rezistent ndaj gërvishjeve i garantuar dhe në zbatim të normes UNI 9428:1989. Materiali të jete rezistent ndaj njollave dhe papastertive.</i></p>
<i>Tavolinë druri</i>	<p><i>Tavoline druri 70 cm x 90cm x 70 cm-h</i> <i>Tavoline me strukture e ndërtuar prej materiali lëndë drusore AHU e lyster me bojë ekologjike ngjyrë qershi me shkëlqim 50%. Lagështia e drurit të jetë 12% Suprina të jetë e përberë nga material lëndë drusore i veshur me shtresë melaminike E1. Në të gjithë perimetërin të jete i rrethuar me material PVC me të njëjtën ngjyrë e trashësi 2 mm. Montimi dhe cmontimi i të bëhet me paisje të posacme dhe cilesore. Materiali i perdorur për kete objekt të jëtë rezistent ndaj gërvishjeve ,njollave dhe papastertive.</i></p>
<i>Karrige</i>	<p><i>Karrige druri</i> <i>Karrige me strukturë prej materiali lëndë drusore AHU e lyster me bojë ekologjike ngjyrë qershi me shkëlqim 50%. Lagështia e drurit të jetë 12% . Nënshtrësia e ndënjës e përber nga dru shumë shtresor I presuar me trashësi 8 mm për të siguruar jetgjatësin e karriges. Veshja e ndënjës të jete me copë prej damask dhe e mbushur me sfungjer me trashësi 40 mm. Materiali i perdorur për kete objekt të jëtë rezistent ndaj gërvishjeve ,njollave dhe papastertive. Trashësia e këmbëve të jetë 4.5 cmx 4.5 cm.</i></p>

Ngjyra për të gjithë materiale e kerkuara të jete uniforme “Qershi”

III.1.3. Në shtojcën 10 “Sasia dhe Grafiku i Lëvrimin” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i Materialit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Dollap druri 1 -kanat</i>	<i>Copë</i>	300
2	<i>Tavoline druri</i>	<i>Copë</i>	240
3	<i>Karrige</i>	<i>Copë</i>	600

III.1.4 Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në Seksionin 1 të dokumentave standarte të tenderit “Hartimi i ofertës” parashikohet shprehimisht:

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.1.7. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon të arsyeshme në mënyrë që të gjykojë mbi përputhshmërinë e specifikimeve teknike me produktet e ofruara. Sa më sipër Komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar të paraqiten nga operatorët ekonomikë në ditën e hapjes së ofertave mostrat e produkteve objekt prokurimi duke përcaktuar elementë të tillë si materiali i produkteve, forma, përmasat etj.

Në rastin konkret Komisioni konstaton se se në ditën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar mostrat e kërkuara për produktet objekt prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues rezulton se ka paraqitur, së bashku me ofertën e tij, sipas shtojcës 1 dhe “*Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike*”, si dhe *Deklaratë për periudhën e garancisë së pajisjeve jo më pak se një vit si riparimin, mirëmbajtjen dhe shërbimin e saj pa pagesë konform specifikimeve teknike*” të detyrueshme për t’u plotësuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi sipas formularit të kërkuar nga autoritetit kontraktor dhe që rezultojnë të fimosura nga ana e ankimuesit, si angazhim i tij konkret për furnizimin e mallrave me të njëjtat specifikime teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.9. Nisur nga sa mësipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, pretendimi i autoritetit kontraktor se mostrat e paraqitura të artikujve dhe materialeve nga operatori ekonomik ankimues, nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit me argumentin se përmasat e mallit nuk janë fikse me ato të kërkuara apo mungesa e një elementi të vogël si mansheta, nuk qëndrojnë për sa kohë që karakteristikat e tjera fizike të mallit të tilla si forma, përbërja/lloji i materialit, cilësia e tij etj janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Ashtu sikundër argumenton edhe ankimuesi në ankesë këto janë defekte të vogla të cilat nuk ndryshojnë as konstruktin as formën apo thelbin e mobiljeve. Komisioni sqaron se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale të përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit apo kataloge teknike kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues është i aftë të prodhojë produktet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu ai konfirmon se është në gjendje të prodhojë produkte sic është kërkuar nga autoriteti kontraktor në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit. Mostra, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të prodhuar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor, gjë e cila vërtetohet plotësisht sipas dokumentacionit dhe mostrave të paraqitura nga ankimuesi. Në rastin konkret përmasat konkrete të mobiljeve janë plotësisht të mundshme për tu realizuara nga ankimuesi në momentin e ekzekutimit të kontratës. Devijime të tilla si 2 cm më shumë apo më pak, përmasat më të mëdha të mostrës së tavolinës se ato të kërkuara apo mungesa e manshetave të dollapit për të realizuar mbylljen e butë janë karakteristika fizike të mallit të cilat janë plotësisht të mundshme për tu realizuar në momentin e lëvrimin të mallit.

III.1.10. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të

kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k për procedurën e prokurimit “Kërkesë Për Propozime”, me Nr. REF-29303-10-10-2017, me objekt Loti I “Baze e Fortë” me fond limit 5,976,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 23.10.2017 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Trajtimin të Studentëve Nr.2 sha Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Murati D” sh.p.k, dhe të korigjojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Murati D” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1697 Protokoli; Datë 14.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar

Leonard Gremshi

Anëtar

Hektor Balluku

Anëtar

Kleves Janku

Anëtar

Odise Moçka

Kryetar

Evis Shurdha